



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1261 Prot.

Tiranë, më 18/08/2025

VENDIM

Nr. 38, DATË 18/08/2025

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MARRJEN E KANDIDATURAVE PËR
NGRITJEN E KOMISIONIT TË SIGURIMIT TË STANDARDEVE TË CILËSISË
NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 38, pika 1, germa "i" dhe "j", në nenin 46, pikat 1, 2, 3 dhe 6 të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; në nenin 30, pika 3, germa "b" dhe nenin 35 të Statutit të Universitetit të Arteve; në nenin 21, pika 2, germa "b" dhe nenin 25 të Rregullores së Universitetit të Arteve; në nenin 4, pika 1, germa "b" dhe "s" të Rregullores së Funksionimit të Senatit Akademik në Universitetin e Arteve, me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Fillimin e procedurës për marrjen e kandidaturave për anëtarë të Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë në Universitetin e Arteve.
2. Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët nga 1 (një) përfaqësues prej secilit Fakultet të UART, 1 (një) përfaqësues specialisti i NJSBC-së pranë UART dhe 1 (një) përfaqësues nga studentët. Përfaqësuesit e fakulteteve në këtë komision duhet të jenë personel akademik me kohë të plotë të ngarkuar nga Dekanati për sigurimin e brendshëm të cilësisë në fakultetet përkatëse.
3. Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere:
 - Për anëtarët, pjesë e personelit akademik:
 - a. Të kenë minimalisht gradën shkencore "Doktor";
 - b. Të kenë përvojë pune si anëtarë të personelit akademik për një periudhë së paku pesëvjeçare;
 - c. Të mos kenë masë disiplinore në fuqi.
 - Anëtari përfaqësues i studentëve, duhet të jetë student me mesatare të përgjithshme mbi 9.
4. Anëtarët e Komisionit zgjidhen nga Senati për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.



5. Aplikimet duhet të paraqiten pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore/P-A, duke dorëzuar kërkesën për vetëkandidim sipas formatit bashkëngjitur këtij vendimi dhe afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është data 28 / 08 /2025.
6. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald Bakalli

Prof. Najada Hamza

Prof. Arben Llozi

Prof. Miltiadh Kutali

Prof. Sadik Spahija

Prof. Lorenc Radovani

Prof. Vladimir Myrtezaj (Grosha)

Prof. Endri Sina

Prof. Rudina Ciko

Prof. Gazmend Gjoka

Prof. Asoc. Dorian Çene

Prof. Asoc. Albes Fusha

Prof. Asoc. Edmond Gjipopulli

Prof. Asoc. Kristina Laço

Prof. Asoc. Genci Fuga

Prof. Asoc. Alert Çeloaliaj

Prof. Asoc. Orion Shima

Enea Trimi (Student FAB)

Rei Kita (Student FM)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2025

**KËRKESË
PËR VETËKANDIDIM
PËR
ANËTAR TË KOMISIONIT TË SIGURIMIT TË STANDARDEVE TË CILËSISË,
UNIVERSITETI I ARTEVE**

TË DHËNA TË KANDIDATIT (Plotëso me germa të mëdha, vendos shenjën X në kuti)

Emri			
Mbiemri			
Atësia			
Datëlindja	_____ dita	_____ muaji	_____ viti
Gjinia	M ☐	F ☐	
Nr. personal (NID)			
Pozicioni aktual (student/personel akademik me kohë të plotë/pjesshme)			
Fakulteti	FM ☐	FAS ☐	FAB ☐
Grada/Titulli (pers. ak.: "Doktor", "Prof. Asoc.", "Prof.")			
Vjetërsia në punë (pers. ak.)			
Nota mesatare (student)			

Deklaroj se të dhënat e paraqitura nga ana ime në këtë kërkesë janë të sakta dhe të vërteta. Jam në dijeni se deklarimet e rreme nga ana ime në këtë kërkesë, përveç përgjegjësisë penale, sjellin automatikisht heqjen e së drejtës për kandidim për këtë pozicion.

(Emër, Mbiemër, Firmë)

